

Papunësia

Të gjithë punëtorët janë të siguar kundër papunësisë. Kush mbetet papunë, zakonisht merr mbështetje financiare për një kohë të caktuar. Të papunët duhet të regjistrohen në Qendrën Rajonale për Ndërmjetësim për Punësim (RAV). Kjo ndihmon në kërkimin e vendit të punës.

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i Papunësisë (ALV) është një institucion shtetëror dhe është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit. Kontributet mujore për të paguhen drejtpërdrejt nga paga, ndërsa punëdhënësi merr pjesën e tij të kontributit. Individët e pavarur nuk mund të sigurohen në Sigurimin e Papunësisë. Ata që mbeten pa punë, marrin një pagesë zëvendësuese mujore (paratë e papunësisë, Arbeitslosengeld) nga një arkë papunësie. Nëse, kur dhe në cilën shumë pagesa e papunësisë do të bëhet, varet nga faktorë të ndryshëm, siç është përvoja e punës ose arsye të tjera përse një person mbetet pa punë.

Hapat gjatë papunësisë

Kush mbetet papunë, duhet të njoftohet sa më shpejt të jetë e mundur te komuna ku banon. Më së miri, kjo duhet të bëhet para ditës së fundit të punës, por jo më vonë se në ditën e parë të papunësisë. Gjithashtu, është e domosdoshme të regjistroheni te qendra rajonale për ndërmjetësim për punë (RAV). Atje do t'ju shpjegohen hapat tjerë.

Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë

Qendra Rajonale për Ndërmjetësimin për Punë (RAV) ndihmon në gjetjen e një vendi pune në mënyrë të shpejtë. Bisedat këshilluese në RAV janë obligative nëse merrni para për papunësinë. RAV ofron gjithashtu kurse ose programe punësimi. Disa prej tyre janë gjithashtu obligative. Edhe personat që nuk kanë punuar kurrë në Zvicër dhe po kërkojnë një vend pune mund të regjistrohen në RAV. Ata nuk marrin para.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-aargau.ch/sq/siguria-sociale/papunesia